

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) 09134000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,097,381 (dy milion e nentdhjete e shtatemije e treqind e tetedhjete e nje) **Leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

“Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”,

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 42, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licencat përkatëse për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*” nenit 40, pika 5, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

3. Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, operatori ekonomik duhet të ketë të paraqes listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacione të tregtimit me pakice të karburanteve:

- në bashkinë Tiranë të ketë të paktën një stacion të tregtimit me pakice të karburanteve sipas Tabelës nr.1;
- Në bashkitë/njësitë administrative sipas tabelës nr 2 të ketë të paktën në 6 stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve
- Në akset rrugore kryesore sipas tabelës nr 3 të ketë të paktën 9 stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve

Operatori ekonomik duhet të paraqes listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice sipas tabelës me poshteme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1:

| Nr | Bashkia Tiranë | Vendodhja (adresa) | Person kontakti |
|----|--------------------------------|--------------------|-----------------|
| 1 | Tiranë Qëndër (Unaza e Vogël) | | |
| 2 | Përgjatë Rrugës së Elbasanit | | |
| 3 | Përgjatë Rrugës së Kavajës | | |
| 4 | Përgjatë Rrugës së Durrësit | | |
| 5 | Përgjatë Rrugës së Dibres | | |
| 6 | Etj..... | | |

Tabela nr. 2:

| Nr | Bashkia/Njesia Administrative | Vendodhja (adresa) | Person kontakti |
|----|-------------------------------|--------------------|-----------------|
| 1 | Kruje | | |
| 2 | Korce | | |

Tabela nr. 3:

| Nr | Aksi kombëtar | Vendodhja (adresa) | Person kontakti |
|----|------------------|--------------------|-----------------|
| 1 | Tiranë-Elbasan | | |
| 2 | Elbasan-Pogradec | | |
| 3 | Pogradec-Korce | | |
| 4 | Tiran-Krujë | | |

***Shenim 3.1:**

Sipas tabelës së mesiperme Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 stacion të shitjes së karburanteve me pakicë në çdo bashki të cituar më sipër.

***Shenim 3.2:**

Ne zbatim te Kodit Civil operatoret ekonomik te disponojne stacione te shitjes se karburanteve me pakice si me poshte:

- Ne pronesi dhe te jene te pasqyruara ne ekstraktin e rregjistrimit tregtar leshuar nga QKB;
- kontrate noteriale qeraje ose furnizimi;

***Shenim 3.3:**

Të gjitha stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve detyrimisht duhen te jene te pajisur me dokumentacion si me poshte:

- Licence leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per distributoret e shitje me pakice, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave;

Shënim 3.4

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet te shitjes se karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë. Në këtë procedurë prokurimi është QTTB Krujë, QTTB Korçë , të cilat kanë lëvishmëri drejt Tiranës dhe në qytetet përkatëse. Për këtë arsye janë kërkuar në Tiranë një numër minimal pikash furnizimi, si dhe në akset kryesore në drejtim të Tiranës.

4. Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 30 diteve nga data e hapjes së ofertave dhe vërtetim të lëshuar po nga ISHTI, i cili të vërtetoj se artikulli objekt prokurimi është brenda parametrave të parashikuara nga standarti Shqiptar në fuqi SSH EN 590:2022;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

5. Subjekti ofertues duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe verteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise pergjate vitit te fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

6. Operatori ekonomik duhet te paraqese Vërtetim teknik te leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK, Leje mjedisore te tipit B, te leshuar nga QKL, Akt-Teknik te leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi lëshuar nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, për depozitat e tregtimit qe vërteton kapacitetet depozituese mbi **500 m³** lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, per te garantuar vazhdimesi ne furnizim, sipas kerkesave te autoritetit kontraktore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë ekonomikë të dëshmojnë me dokumenta konkrete për permbushjen e këtyre kriterëve.

7. Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me karte elektronike te personalizuar me targon e cdo automjeti te autoritetit kontraktor ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave te ndodhura ne karten elektronike te personalizuar me targon e mjetit në lëng me bot, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktore. Karta elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri ne përfundimin e plotë të kontrates.
- Operatori ekonomik duhet te mbuloje furnizimin nepermjet karteve elektronike te personalizuar, sipas adresave te kerkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “**Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem**“, Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartes elektronike.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit te sasisë se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit, si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet te ofroje edhe mundesine e afishimit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjetit shteteror drejt mjeteve private, si dhe sherbimin e dergimit te fotografive me ane te emailit per cdo

furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakice me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj .

- Disponimi/Ëkzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (ëëbpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kërkuara mesipër, do të demonstrohen nga ana e operatoreve ekonomik pjesëmarrës me shëmbuj për zbatimin në praktike, në prani anëtarëve të KVO-së së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mesipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (ëëbpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për skualifikim.

Shënim:

Sasitë e kërkuara nga AK, janë sasi të pritshme, e llogaritur nga AK në bazë të cmimit mesatar për litër nëpërmjet studimit të tregut. Kjo sasi mund të jetë e ndryshueshme në varësi të cmimit të publikuar nga APP në buletin javor.

SHënim:

Referuar udhëzimeve të APP, për zerat në DST që mund të jete paraqitur marke/brand, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike.

Shënim:

Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi të rreme do të konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtim të O.E. nga procedurat e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika , gërma ç,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Është kërkuar që operatori ekonomik të vetdeklarojë deklaratimet e mesipërme pasi AK kërkon garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 11.08.2023; Ora: 10:00; Vendi: www.app.gov.al, “Identitek” SHA, Tiranë.

Njëësia e Prokurimit:

Z. Erald MIHALI

Znj. Lorena BARJAMAJ

Znj. Misona SHPUZA